



MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
BYROJA E ZHVILLIMIT E ARSIMIT

**PROGRAMI MËSIMOR
I INOVUAR**

GJUHËS SHQIPE

KLASA I

Shkup, qershor 2007

ARSIMI FILOR TETËVJEÇAR

1. HYRJE

Gjuha shqipe, si një nga tiparet themelore të identitetit kombëtar, paraqet qëllimin parësor në tërë arsimin e detyrueshëm fillor 8-vjeçar.

Gjuha shqipe fillon të mësohet në familje, vazhdon më pas në arsimin parashkollor dhe në arsimin fillor, duke i aftësuar nxënësit për të shkruar e për të lexuar nëpërmjet ushtrimeve të të folurit dhe të të dëgjuarit.

Në klasën e parë të shkollës fillore 8-vjeçare, gjuha shqipe fillon të mësohet në mënyrë sistematike nëpërmjet të dëgjuarit, të folurit dhe aktiviteteve të tjera që lidhen me aftësimin dhe shkathtësimin e nxënësve për lexim-shkrimin fillestar.

Mësimi i gjuhës shqipe në shkollën fillore shoqërohet me ndryshime të mëdha, të cilat bëhen hap pas hapi dhe në pajtim me moshën dhe dallimet individuale të fëmijëve, që lidhen me zhvillimin dhe kultivimin e shprehive dhe shkathtësive të komunikimit gjatë të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit. Gjuha shqipe në klasën e parë mësohet nëpërmjet formave, metodave dhe aktiviteteve të larmishme, me qëllim që zotërimi i formës standarde të saj të bëhet me interesim, kënaqësi dhe vullnet.

2. QËLLIMET PËR MËSIMIN NË KLASËN I:

- **zhvillimi i dashurisë dhe interesimit për gjuhën standarde shqipe dhe i ndjenjës për përkatësinë** - zhvillimi i identitetit shoqëror dhe personal, që nënkupton rolin dhe rëndësinë e gjuhës gjatë komunikimit, njohjen e botës, marrëveshjet dhe argëtimin;
- **përvetësimi i shkathtësive për të komunikuar në situata të ndryshme** - që nënkupton: të shprehen qartë, në mënyrë mëmbajtësore dhe sipas normës standarde të gjuhës shqipe; të dëgjojnë me vëmendje dhe ta kuptojnë atë që u thonë bashkëbiseduesit gjatë të folurit verbal dhe joverbal; të njohin ndjenjat personale dhe ndjenjën e empatisë gjatë komunikimit; të aftësohen për të shprehurit verbal dhe joverbal të emocioneve; të bashkëndjejnë me familjen, moshatarët dhe shokët;
- **zhvillimi i aftësive të lexim-shkrimit fillestar** - që nënkupton shfaqjen e interesimit për përvetësimin dhe paraqitjen e formës grafike të sistemit të gjuhës shqipe, duke zotëruar motorikën e lëvizjes së dorës dhe gishtërinjve, përdorimin e mjeteve mësimore sipas udhëzimeve të dhëna, dëshirën për zgjidhjen e pavarur të një detyre praktike; aftësinë për të shkruar drejt shkronjat (ndaras dhe në fjalë); përvetësimin e aktiviteteve motorike si pjesë përbërëse të zhvillimit të personalitetit;
- **nxitja e interesimit, dashurisë dhe dëshirës për njohjen e letërsisë popullore dhe artistike (shqiptare dhe botërore) dhe gatishmërisë për shfrytëzimin e librit si burim të informacioneve dhe si mjet mësimor** – që nënkupton aftësimin e nxënësve për të lexuar, përjetuar dhe analizuar tekstet e përshtatshme për moshën e nxënësve, formimin e pikëpamjeve të drejta për botën dhe jetën, kultivimin e vullnetit të tyre, zhvillimin e fantazisë dhe formimin e karakterit të nxënësit;
- **zhvillimi i kulturës së të folurit (të shprehurit me gojë dhe me shkrim) dhe të kulturës së medias** – që nënkupton zhvillimin e aftësive për përdorimin human dhe të orientuar të gjuhës dhe mediejeve në funksion të kultivimit dhe shfrytëzimit të traditës kombëtare, kulturore dhe gjuhësore si bazë për marrëdhënie humane me kulturat e tjera te ne dhe në botë;
- **zhvillimi i proceseve të të menduarit (kujtesa, analiza, sinteza, abstraktimi, të menduarit logjik)** - që nënkupton aftësimin e nxënësit për analizë dhe sintezë të njësive gjuhësore, të krahasojë dhe të emërtojë; të interpretojë mëmbajtjet në pikëpamje gjuhësore, të njohë fjalë dhe terma të rinj që hasen në mëmbajtjet mësimore, të aftësohen të vërejnë ndërlidhjen midis shkathtësive (në mes të dëgjuarit, të folurit dhe të lexuarit); të zhvillohen aftësitë shoqërimore (asociative) në mënyrë analoge me tekstet letrare, përkatësisht nxënësit të radhisin shoqërimet (asociacionet) e tyre sipas aftësive personale dhe të nxitura prej teksteve; të shfaqin mendime fillestare.

3. QËLLIMET KONKRETE

Fusha programore: LEXIM-SHKRIMI FILLESTAR			
1. Përgatitja për lexim fillestar			
Objektivat	Përmbajtjet	Konceptet	Veprimtaritë dhe metodat
Nxënësi/nxënësja: - të aftësohet për të vëzhguar njerëz, kafshë, sende dhe dukuri, të vërejë veçoritë e tyre thelbësore dhe të shprehet me gojë me fjali të plota	- Të vëzhguarit, të vërejturit, të shprehurit e lirë, të treguarit dhe të shkruarit	- vëzhgim - të vërejtur - të shprehur - tregim - përshkrim	- Ushtrime për të vëzhguar njerëz, kafshë, sende dhe dukuri, për të vërejtur veçoritë e tyre thelbësore dhe për t'i shprehur nëpërmjet të treguarit dhe përshkrimit të tyre duke shfrytëzuar mjete përkatëse didaktike dhe vizita në mjedisin e afërt
- të aftësohet t'u përgjigjen pyetjeve me fjali të plota dhe të parashtrijë pyetje kur kanë nevojë	- Pyetje dhe përgjigje	- pyetje - përgjigje	- Ushtrime dhe aktivitete me lojëra për t'u përgjigjur në pyetjet lidhur me atë që kanë parë, dëgjuar dhe përjetuar - Ushtrime dhe aktivitete me lojëra për parashtrimin e pyetjeve
- të aftësohet për të dalluar fjalinë si njësi gjuhësore, të njihet me përmbajtjen dhe funksionin e saj - të aftësohet për të zotëruar kuptimin e fjalës si pjesë e fjalisë dhe si njësi për emërtimin e sendeve	Kuptimi për: - Fjalia - Fjala	- fjali - fjalë	- Lojëra për të dalluar fjalinë gjatë të folurit - Ushtrime për të dalluar fjalët brenda fjalisë si pjesë të fjalisë dhe si shenja (emra) me të cilët emërtohen frymorë, sende dhe dukuri (metoda analitiko-sintetike) - Ndërtimi i fjalive sipas fjalëve të dhëna
- të dallojë tingullin si pjesë të fjalës; - të dallojë tingullin në pozicione të ndryshme të fjalës (fillim, mes dhe fund të fjalës) dhe t'i shqiptojë drejt tingujt	Kuptimi për tingullin	-tingull	- Ushtrime analitiko-sintetike për të formuar kuptim për tingullin si pjesë të fjalës
- të aftësohet për paraqitjen e	- Vija të drejta, vija të	- Vija të drejta,	- Ushtrime për të shkruar nëpërmjet vizatimit

<p>saktë grafike të elementeve të shkronjës</p>	<p>shtrira, vija të drejta pingule, vija të pjerrëta (majtas dhe djathtas), gjysmërrathë të mbështetur te vija poshtë dhe vija lart, gjysmërrathë nga e majta dhe nga e djathta, rrethi</p>	<p>vija të shtrira, vija të drejta pingule, vija të pjerrëta (majtas dhe djathtas), gjysmërrathë të mbështetur te vija poshtë dhe vija lart, gjysmërrathë nga e majta dhe nga e djathta, rrethi</p>	<p>të lirë të elementeve të shkronjave: vija të drejta, vija të shtrira, vija të drejta pingule, vija të pjerrëta (majtas dhe djathtas), gjysmërrathë të mbështetur te vija poshtë dhe vija lart, gjysmërrathë nga e majta dhe nga e djathta, rrethi në hapësirë të kufizuar</p>
---	---	---	--

2. Leximi

2.1. Drejtshkrimi

Objektivat	Përbërësit	Konceptet	Veprimtaritë dhe metodat
<p>- të aftësohet t'i njohë simbolet e tingujve dhe t'i lidhë ato brenda fjalëve (kuptimi për shkronjën)</p> <p>- të aftësohet për të lexuar fjalë dhe tekste nga abetarja dhe nga mediet e tjera</p>	<p>- Simbolet grafike (për shkronjat e shtypit) të alfabetit të gjuhës shqipe</p> <p>- Përvetësimi i shkronjave të vogla dhe të mëdha të shtypit duke i shkruar ato një nga një</p>	<p>- shkronjat e shtypit të alfabetit të gjuhës shqipe</p> <p>- shkronja (simbol, grafemë, shenjë)</p>	<p>- Ushtrime për të krijuar shprehje të nxënësit për frymëmarrje të rregullt dhe për respektimin e rregullave dhe normave higjeniko-teknike</p> <p>- Ushtrime për dallimin e shkronjës si simbol grafik të tingullit dhe për shqiptimin e tij, drejtshqiptimi dhe dallimi simultan i fjalës</p> <p>- Ushtrime për leximin e fjalëve dhe teksteve nga abetarja dhe mediet e tjera për bashkimin e fjalëve në fjali (metoda analitiko-sintetike me elemente të metodës globale)</p> <p>- Ushtrime të lexuari për të kontrolluar si e konceptojnë dhe si e kuptojnë tekstin</p> <p>- Ushtrime për evitimin e gabimeve që i bëjnë më së shpeshti gjatë të lexuarit (shqiptimi jonormativ i fjalëve, theksimi i gabuar, mosleximi i tingujve dhe rrokjeve, sidomos i tingujve dhe rrokjeve që ndodhen në fund të fjalës, zëvendësimi i tingujve dhe frymëmarrja jo e rregullt)</p>

- të njihet me nevojën për të shkruar me shkronjë të madhe në fillim të fjalisë dhe për t'i shkruar emrat e përveçëm me shkronjë të madhe	- Përdorimi i shkronjës së madhe në fillim të fjalisë - Shkrimi i emrave të përveçëm me shkronjë të madhe	- përdorimi i shkronjës së madhe	- Ushtrime për të dalluar shkronjat e mëdha dhe të vogla brenda fjalisë - Ushtrime për të dalluar shkronjën e madhe të emrat e përveçëm dhe në fillim të fjalisë
- Të njihet me shenjat e pikësimit dhe me funksionin e tyre, të udhëzohet për t'i përdorur drejt ato gjatë leximit (kuptimi për shenjat e pikësimit)	Shenjat e pikësimit: - pika - presja - pikëpyetja - pikëçuditja	- shenjat e pikësimit	- ushtrime për t'i njohur shenjat e pikësimit dhe për t'i zbatuar ato gjatë leximit
3. Shkrimi			
Objektivat	Përmbajtjet	Konceptet	Veprimtaritë dhe metodat
- t'i përvetësojë shkronjat e vogla dhe të mëdha të dorës, bashkimin e tyre në fjalë dhe të aftësohet për të shkruar fjalë dhe fjali të shkurtra (kuptimi për shkronjat e dorës) - të aftësohet për t'i plotësuar fjalët me shkronjat që mungojnë dhe fjalitë me fjalët që mungojnë - të aftësohet për të krijuar dhe për të shkruar në mënyrë të pavarur fjalë e fjali sipas ilustrimeve, sendeve të dhëna etj.	- Përvetësimi i shkronjave të vogla e të mëdha të shkrimit duke i shkruar ato një nga një	- alfabeti i gjuhës shqipe	- Ushtrime për përvetësimin e shkronjave të vogla dhe të mëdha të dorës (përpunimi grafik) duke i shkruar një nga një dhe shkrimi i fjalëve dhe fjalive të shkurtra - Ushtrime për shkrimin e drejtë dhe për lidhjen e shkronjave në fjalë dhe në fjali (metoda analitiko-sintetike me elemente të metodës globale) - Ushtrime për plotësimin e fjalëve me shkronjat që mungojnë dhe të fjalive me fjalët që mungojnë - Ushtrime për kopjimin e tekstit (nga shkrimi i dorës me shkrim të dorës dhe nga shkrimi i shtypit me shkrim të dorës) - Ushtrime për ndërtimin e pavarur të fjalive sipas fjalëve, ilustrimeve, sendeve të dhëna etj.

Fusha programore: GJUHA

1. Gramatika

Objektivat	Përmbajtja	Konceptet	Veprimtaritë dhe metodat
- të aftësohet për të dalluar tingujt dhe zhurmat dhe t'i shqiptojë drejt tingujt brenda fjalës dhe fjalët brenda fjalisë	- Tingulli / zhurma	- tingull / zhurmë	- Ushtrime dhe aktivitete me lojëra për dallimin e tingullit dhe të zhurmës - Njohja e tingullit brenda fjalës, dallimi, nyjëtimi dhe shqiptimi i drejt i tingujve brenda fjalës dhe i fjalëve brenda fjalisë
- të aftësohet për të ndërtuar si duhet fjalitë dhe për t'i renditur drejt fjalët në fjali	- Rendi i fjalëve në fjali	- radhitja e fjalëve në fjali	- Ushtrime dhe aktivitete me lojëra për ndërtimin e drejt të fjalive sipas radhitjes normative të fjalëve brenda fjalisë
- të aftësohet për të dalluar fjalinë dëftore, pyetëse e nxitëse dhe për t'i përdorur drejt ato	- Fjalja dëftore, pyetëse dhe nxitëse	- fjali pyetëse dhe nxitëse	- Ushtrime dhe aktivitete me lojëra për të vërejtur e për të ndërtuar fjali pyetëse, dëftore dhe nxitëse në formën gojore dhe të shkruar sipas mënyrës së thënies së tyre dhe sipas shenjave të pikësimit
- të aftësohet për të dalluar fjalinë pohore dhe mohore	- Fjalja pohore dhe mohore	- fjali pohore dhe mohore	- Ushtrime për dallimin dhe përdorimin e fjalive pohore dhe mohore
- të aftësohet për t'i emërtuar personat, qeniet e gjalla, bimët, sendet dhe dukuritë, të dijë kuptimin e fjalës që është emër dhe t'i dallojë fjalët emra në fjali	- Fjalët që emërtojnë qenie të gjalla dhe sende	- emër	- Ushtrime për dallimin e emrave nga fjalët e tjera dhe për të emërtuar njerëz, sende, bimë dhe dukuri
- të aftësohet për të dalluar gjininë dhe numrin tek emrat	- Gjinia dhe numri tek emrat	- kategoria gramatikore e gjinisë dhe e numrit	- Shkrimi i fjalive sipas emrave të dhënë duke u përqendruar te kategoria e gjinisë dhe e numrit
- të aftësohet për t'i shqiptuar e për t'i shkruar drejt me fjalë numërorët deri	- Numërorët deri në 20	- numërori si lloj fjalësh	- Ushtrime për shqiptimin e drejt dhe për shkrimin me fjalë e numërorëve deri në

në 20			20 (integrimi me matematikën)
- të aftësohet t'i ndajë fjalët në rrokje duke përdorur vizën	- Ndarja e fjalëve në rrokje	- rrokja	- Ushtrime praktike për ndarjen e fjalëve në rrokje (me gojë dhe me shkrim) dhe për mbartjen e një pjese të fjalës në rresht të ri
2. Drejtshqiptimi dhe drejtshkrimi			
- të aftësohet për t'i dalluar tingujt dhe për t'i përdorur ata si duhet	- Dallimi i tingujve: ç, dh, ë, gj, l, ll, nj, q, rr, s, sh, th, y, xh	- fonema	- Ushtrime për dallimin e për shqiptimin e drejt të tingujve dhe përdorimi normativ i tyre gjatë të shkruarit
- të aftësohet për ta përdorur si duhet shkronjën e madhe	- Shkrimi i shkronjës së vogël dhe të madhe	- shkronja e madhe	- Ushtrime për përdorimin e shkronjës së madhe në fillim të fjalisë dhe kur shkruajnë emrin dhe mbiemrin
- të aftësohet për t'i përdorur shenjat e pikësimit kur shkruan	Shenjat e pikësimit: - pika - presja - pikëpyetja - pikëçuditja		Ushtrime për përdorimin e shenjave të pikësimit

Fusha programore: LEXIMI LETRAR DHE LEKTYRA

1. Leximi dhe përpunimi i tekstit

Objektivat	Përmbajtja	Konceptet	Veprimtaritë dhe metodat
- të aftësohet të vërejë dhe të dallojë titullin, të dallojë tekstin, ilustrimin, autorin dhe t'i gjejë faqet në libër	- Teksti: titulli, emri i autorit, përmbajtja, ilustrimi	- titull - ilustrim - autor	- Ushtrime për të vërejtur, njohur dhe dalluar titullin e tekstit, tekstin, autorin, ilustrimin dhe për të përcaktuar faqen
- të aftësohet për të lexuar me zë dhe me ndjenja - të aftësohet të lexojë në role dhe ta përcaktojë temën dhe idenë e tekstit	- Leximi shprehës - Tema - Porosia - Tekstet: proza, poezia	- lexim shprehës - tekst - porosi - tekst dramatik	- Ushtrime për lexim shprehës dhe përjetimi i tekstit - Ushtrime për gjetjen e temës dhe të porosisë

	(vjersha), teksti dramatik, proverbat, gjëgjëzat, fjalëshpejtat	- proverb - gjëgjëzë - fjalëshpejtë	
- të aftësohet t'i dallojë ngjarjet dhe personazhet	- Ngjarja - Personazhi në tekst (tregimi, përralla, vjersha, gjëgjëza)	- pjesë (paragraf) - tregim - përrallë - ngjarje - personazh	- Ushtrime për të kuptuar dhe për të kontrolluar përmbajtjen e pjesës së lexuar të tekstit (fjalja, pjesa, përralla, vjersha, gjëgjëza) duke vërejtur fjali karakteristike mbi ngjarjet dhe personazhet
- të aftësohet të lexojë poezi dhe të bëjë dallimin mes vargut dhe strofës së poezisë	- Vjersha (vargu, strofa)	- vjershë - varg - strofë	- Ushtrime për leximin dhe përjetimin e vjershës me qëllim të dallimit të vargut nga strofa - Ushtrime për të mësuar përmendësh vjershën (një pjesë të saj)
- të aftësohet të lexojë në mënyrë të kuptueshme duke respektuar shenjat e përdorura të pikësimit dhe ta përshtatë intonacionin me natyrën dhe përmbajtjen e tekstit (të aftësohet të lexojë me gëzim, me hidhërim, me shaka) si dhe t'i theksojë drejt fjalët në fjali	- Leximi me zë	- lexim me zë - lexim shprehës	- Ushtrime për lexim të drejtë dhe të kuptueshëm
- të aftësohet të lexojë në vete (pa zë)	- Leximi pa zë (në vete)	- lexim pa zë	- Ushtrime për aftësimin e nxënësve për të lexuar pa zë dhe për ta kuptuar brendinë e tekstit - Vlerësimi i leximit pa zë nëpërmjet ritregimit

2. Lektyra			
- të aftësohet të lexojë në mënyrë të pavarur pjesë të lekturës	1. M. Hoxha: “ <i>Vallja e shkronjave</i> ” 2. O. Grillo: “ <i>Valbona bleu ylberin</i> ” 3. V. Grim: “ <i>Borëbardha</i> ” 4. L. Tolstoj: “ <i>Tregime</i> ” 5. O. Nikollova: “ <i>Zoki Poki</i> ” (Nga lista e lekturave lexohen dhe përpunohen të paktën 3 lektyra)	- lektyra	- Njohja e nxënësve me titujt e lekturave që do të përpunohen gjatë gjysmëvitit të dytë - Udhëzimi i nxënësve për mënyrën sesi dhe ku ta gjejnë librin - Udhëzim dhe motivim për lexim të pavarur të librave...

Fusha programore: TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA			
1. Të shprehurit me gojë			
Objektivat	Përmbajtja	Konceptet	Veprimtaritë dhe metodat
- të aftësohet për të dëgjuar e për të marrë pjesë në biseda me temë të caktuar	- Dëgjimi: të folurit dhe biseda për tema lidhur me jetën në familje, shkollë dhe mjedisin jetësor	- të folurit/të biseduarit	- Ushtrime dhe udhëzime se si të dëgjojnë kur flasin të tjerët dhe për të marrë pjesë në bisedë duke treguar, duke pyetur dhe duke u përgjigjur lidhur me temën e caktuar, duke shfrytëzuar sende, fotografi dhe mjete audiovizuale
- të aftësohen të ritregojnë (në mënyrë të lirë dhe me anë të pyetjeve) përmbajtje të shkurtra të përpunuara	- Ritregimi i tekstit, i përmbajtjes së filmit vizatimor, emisioneve televizive, tregimeve dhe përrallëzave	- Ritregim	- Ushtrime për ritregim të lirë të përmbajtjeve të shkurtra e të njohura (përrallave, tregimeve për kafshët etj.) dhe duke iu përgjigjur pyetjeve
- të aftësohet të tregojë për një ngjarje, të tregojë sipas radhës së	Tregimi - Sipas radhës së ilustrimeve	- tregim	- Ushtrime për të treguar në mënyrë të thjeshtë dhe të lirë të ndonjë ngjarjeje të

ilustrimeve, sipas disa fjalëve të dhëna etj.	- Sipas fjalëve të dhëna		përjetuar në familje, në shkollë, në shëtitje, në pushime etj., nëpërmjet të shprehurit – të folurit spontan dhe biseda sipas kërkesash më të mëdha, të treguarit sipas radhës së ilustrimeve, fjalëve të dhëna etj.
-të aftësohet të përshkruajë tipare karakteristike nëpërmjet vëzhgimit të bimëve, sendeve e dukurive	-Përshkrimi: send, kafshë, bimë etj.	përshkrim	-Ushtrime për të përshkruar nëpërmjet vëzhgimit, dallimit, zbulimit, të vërejturit dhe pasurimi i fjalorit duke përdorur sinonimet (vajzë-gocë, derë-portë)
- të aftësohet për të recituar vjersha; - të bëjë dramatizimin e vjershës në formë të dialogut - thotë fjalëshpejta	-Recitimi -Dramatizimi	-recitimi	-Ushtrime drejtshqiptimi duke recituar vjersha, duke dramatizuar vjersha të përpunuara dhe duke thënë fjalëshpejta me theks në rrokje karakteristike.
2. Të shprehurit me shkrim			
- të aftësohet të kopjojë fjali me fjalë karakteristike duke respektuar elementet e bukurshkrimit	- Kopjimi i fjalëve dhe fjalive	- Kopjim	- Ushtrime drejtshkrimi për kopjimin e fjalëve dhe fjalive me qëllim të përsosjes së teknikës së bukurshkrimit
- të aftësohet të përshkruajë fjali me fjalë, disa nga të cilat janë paraqitur me ilustrime ose vizatime, kurse disa fjalë të caktuara t'i zëvendësojnë me sinonimet e tyre (pa përdorur fjalën sinonim)	- Kopjimi me ndihmën e ilustrimit dhe vizatimit; Përdorimi i fjalëve që kanë forma të ndryshme por që janë të njëjta ose të ngjashme për nga kuptimi	- fjalë të ndryshme për nga forma, kurse me kuptim të njëjtë a të ngjashëm (sinonime)	- Ushtrime për t'iu përgjigjur pyetjeve për një ngjarje të përjetuar me ndihmën e ilustrimeve, vizatimeve etj., të sinonimeve
- të aftësohet të tregojë ngjarje të përjetuara, të ritregojnë tekste të shkurta, përmbajtje nga emisionet TV, të përshkruajnë frymorë, sende, bimë, dukuri	- Tregimi, ritregimi dhe përshkrimi	- Tregim - Ritregim - Përshkrim	- Ushtrime për tregimin dhe ritregimin e ngjarjeve, teksteve të shkurtra nga abetarja, libri i leximit, revistat, emisionet TV dhe përshkrimi i bimëve
- të aftësohet për t'i përdorur drejt në fjalë shkronjat për disa zanore dhe	- Diktimi i lirë - Diktimi për përmirësim	- Diktim	- Ushtrime për të kontrolluar dhe për të shkruar si duhet brenda fjalëve zanoret ë

bashkëtingëllore	gabimesh - Autodiktimi		dhe y si dhe bashkëtingëlloret: ç, dh, gj, l, ll, nj, q, rr, s, sh, th, xh
- të aftësohet të shkruajë urime të thjeshta me rastin e festave të ndryshme, ditëlindjes etj.	- Urimi	- Urim	- Ushtrime për të shkruar një urim të thjeshtë me rastin e ndonjë feste ose të ditëlindjes etj.

Fusha programore: KULTURA E MEDIES

Objektivat	Përmbajtja	Konceptet	Veprimtaritë dhe metodat
- të dijë përse na shërben televizori	- Emisioni TV	- emision televiziv	- Ushtrime duke shikuar emisione televizive që përkojnë me moshën e nxënësve (integrimi me të shprehurit dhe krijimtarinë)
- të udhëzohet si ta përdorë filmin dhe t'i hetojë ngjashmëritë dhe dallimet midis filmit dhe mjeteve të tjera (librit me ilustrime dhe librave të tjerë)	- Filmi (filmi vizatimor, filmi i animuar)	- film (vizatimor dhe i animuar)	- Ushtrime për të njohur filmin dhe rëndësinë e tij për mësimin si mjet dhe përmbajtje
- të aftësohet të bëjë dallimin mes shfaqjeve teatrore dhe shfaqjeve me kukulla, t'i vërejë dallimet kryesore mes tyre dhe teksteve letrare	- Teatri (shfaqja me kukulla, tekstet letrare)	- teatër - shfaqje me kukulla - tekst letrar	- Shikimi i shfaqjeve teatrore dhe shfaqjeve me kukulla (bisedë rreth tyre)
- të ngjallet interesi për leximin e shtypit për fëmijë	- Shtypi për fëmijë	- Shtyp për fëmijë - Revistë	- Njihen me rubrikat e revistës dhe aftësohen për shfrytëzimin e informatave të saj
- Si të huazohen librat nga biblioteka dhe si të kujdesen për to?	- Biblioteka e shkollës	- bibliotekë - bibliotekë e shkollës - bibliotekar	- Vizita, njohja, qëllimi dhe shfrytëzimi i bibliotekës së shkollës

4. UDHËZIME DIDAKTIKE

- Udhëzime për integrim me lëndët e tjera:

Në klasën e parë gjuha shqipe është lëndë e vetme ku ndërthuren (integrohen) kërkesat për lexim-shkrim, për fitimin e njohurive gramatikore, për pasurimin e fjalorit etj.

Gjuha është një veprimtari komunikuese e domosdoshme për gjithë lëndët shkollore. Pra, gjuha nuk mund të mësohet e ndarë nga lëndët e tjera, si: dituri natyre e shoqërie, arsim figurativ, arsim muzikor, arsim fizik... Temat nga këto lëndë do të ndihmojnë zhvillimin e shkathtësive të komunikimit, formimin kulturor të fëmijës dhe pavarësimin individual të tyre. Përpos këtyre lëndëve, mësimdhënësi mund të zgjedhë edhe tema të tjera që integrohen me gjuhën shqipe, si: tema nga televizioni, revistat dhe gazetat për fëmijë dhe rrethi jetësor i fëmijëve.

Integrimi a ndërthurja e mësimdhënies së lexim-shkrimit me tema nga arsimit figurativ, arsimit muzikor dhe arsimit fizik u ofron nxënësve më shumë kënaqësi, vullnet dhe dëshirë për të punuar dhe për të shkruar në mënyrë të pavarur.

- Udhëzime për organizimin e përmbajtjes programore:

5 orë në javë, 180 orë në vit

Fushat programore:

- Lexim-shkrimi fillestar – 60 orë
- Gjuhë – 20 orë
- Të lexuarit dhe letërsia – 60 orë
- Të shprehurit dhe krijimtaria – 30 orë
- Kultura e medias – 10 orë

(Fushat programore realizohen gjatë gjithë vitit shkollor duke u ndërlidhur e duke u plotësuar me njëra-tjetrën, kurse fondi i përcaktuar i orëve sipas fushave shërben vetëm si orientim për mësimdhënësin)

Nga fondi i përgjithshëm i orëve të parashikuara sipas fushave programore mund të bëhen shmangie të vogla në pajtim me të veçantat e mjedisit ku ndodhet shkolla. Po kështu, në kuadër të fondit të përgjithshëm vjetor të orëve në fushat programore lejohen disa shmangie edhe sa i përket dendurisë së objektivave, përmbajtjeve dhe veprimtarive konkrete. Ç'është e vërteta, numri i orëve që u

kushtohen atyre mund të përshtatet me nevojat e shkollës së caktuar (mjedisit jetësor prej nga vijnë nxënësit, statusi i tyre kulturor-shoqëror dhe arsimor, përgatitja paraprake e nxënësve, ndjekja paraprake e institucionit parashkollor). Në raste të tilla disa përmbajtje do të përsëriten disa herë në krahasim me të tjerat që do të përpunohen me një fond më të vogël orësh. (Bie fjala: Një shkollë që për fushën programore “Komunikimi” ka propozuar gjithsej 85 orë, për qëllimin e parë mund të shfrytëzojë 6 orë, 3 orë për përmbajtjen e parë dhe 3 orë për të dytën, kurse një shkollë tjetër për këtë fushë programore dhe për të njëjtin qëllim, këtë raport mund ta ketë 8 orë, përkatësisht 4/2 etj.). Është e këshillueshme që në funksion të nevojave dhe interesave të nxënësve të ketë fleksibilitet edhe sa i përket kohës sa zgjatin orët.

- Metodat, format dhe mjetet e punës

Për të gjitha fushat programore që parashikohen për lëndën e Gjuhës shqipe këshillohet shfrytëzimi dhe kombinimi i të gjitha metodave, formave dhe mjeteve të mësimdhënies **ndërvepruese (interaktive), aktuale dhe bashkëkohore**, sidomos të: **metodës së lojës, metodës për zgjidhjen e problemeve dhe metodës kërkimore** që janë më adekuate për specifikat e të nxënësve të fëmijët e kësaj moshe.

- Qasja individuale ndaj punës edukativo-arsimore

Në bazë të njohurive shkencore për dallimet në zhvillimin e fëmijëve, është e nevojshme të bëhet përshtatja e mësimdhënies me zhvillimin dhe me nevojat e arritjet individuale të nxënësve. Me fjalë të tjera, nevojitet zbatimi i teknikave dhe strategjive që i kërkon **qasja individuale** gjatë realizimit të punës edukativo-arsimore me nxënësit.

- Përfshirja e prindërve në veprimtarinë e mësimdhënies

Familja është shkolla e parë për fëmijët dhe një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e fëmijës. Së këtejmi, gjatë realizimit të objektivave, përmbajtjeve dhe veprimtarive në lëndën e Gjuhës shqipe duhet të sigurohet **komunikimi bashkëpunues me prindërit e nxënësve dhe përfshirja e tyre në punën e shkollës**, në funksion të: zhvillimit dhe përkrahjes së marrëdhënieve prind-nxënës; kultivimit dhe zhvillimit të kulturës së të folurit në familje; realizimit të disa objektivave dhe përmbajtjeve të programit dhe të organizimeve letrare në kuadër të shkollës; informimit të prindërve; këmbimit të përvojave sa u përket specifikave të nxënësve dhe veprimeve ndaj tij etj.

- Mjetet mësimore:

- Për realizimin e mësimdhënies së lëndës Gjuha shqipe në klasën e parë **nuk këshillohet shfrytëzimi i abetares**, por **parapëlqehet përdorimi i doracakut për leximin dhe shkrimin fillestar** i miratuar nga ana e ministrit të arsimit; i doracakëve metodikë për realizimin e mësimdhënies dhe të veprimtarisë edukativo-arsimore në gjuhë shqipe, si dhe i doracakëve e përmbledhjeve me lojëra didaktike dhe me lojëra të foluri.
- **Burimet e të mësuarit në mjedisin e afërt**: mbishkrimet e reklamave, resurset e mjedisit rrethues që do të vëzhgohen e do të përshkruhen, objekte me karakter kulturor, edukativ, publik dhe shërbyes (dyqan, kinema, teatër, bibliotekë, stacion autobusësh etj.), situata komunikuese dhe situata të tjera përkatëse mes njerëzve në shkollë, në familje dhe në rrethin jetësor.
- **Enciklopedi për fëmijë të shtypura nga shtëpi botuese të popullarizuara e të dëshmuara**
- **Softuerë arsimorë kompjuterikë** për pasurimin e kulturës së të folurit e të kulturës gjuhësore – **programi toolkid dhe CD-ROM-a të tjerë multimedialë të verifikuar** me lojëra edukative përkatëse – të verifikuara nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të RM-së.
- **Revista për fëmijë me traditë të dëshmuar, të miratuara e të verifikuara që i përgjigjen moshës së nxënësve**
- **Krijime letrare për fëmijë nga autorë të njohur shqiptarë e të huaj (që për nga përmbajtja, ana estetike dhe vlera i përgjigjen moshës së nxënësve)**
- **Mjete audio-vizuale, auditive, vizuale dhe mjete të tjera me veti kinetike** – programe televizive, emisione për fëmijë, filma të animuar dhe artistikë për fëmijë; videokaseta, disqe të DVD e CD-së me filma të animuar e me filma artistikë dhe me tekste të letërsisë popullore dhe artistike, me ngjarje të regjistruara, ditëlindje, me shfaqje teatrore e me shfaqje kukullash etj.; audiokaseta me zëra të incizuar, emisione lajmesh të incizuara, tekste të lexuara në mënyrë artistike; aplikacione, ilustrime, makete; skena kukullash dhe të teatrit; sende të lëvizshme me efekte akustike dhe sende të tjera sipas nevojave që kërkon mësimdhënia e kësaj lënde.

5. VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE

KONTROLI DIAGNOSTIK DHE VLERËSIMI

Në fillim të vitit shkollor mësuesi bën kontrollin diagnostik për të konstatuar zhvillimin dhe nevojat individuale të çdo nxënësi në mënyrë që të bëjë planifikimin cilësor të detyrave dhe veprimtarive të diferencuara dhe bashkëpunimin më efektiv me prindërit e nxënësve. Me anë të këtij kontrolli konstatohet shkalla e parangjohurive, niveli i socializimit, zhvillimi emocional dhe fizik i nxënësve. Diagnostikimi mund të realizohet nëpërmjet vëzhgimit, bisedës, pyetjeve e përgjigjeve, bisedës me prindërit e nxënësve, me përdorimin e instrumenteve adekuate për moshën e tyre etj.

VLERËSIMI FORMATIV - Gjatë mësimdhënies së Gjuhës shqipe në klasën e parë fillore parashikohet vlerësimi formativ, i cili përfshin përpilimin dhe mbajtjen e portfolios së nxënësit ku hyjnë:

- mbledhja e të dhënave (punimeve, krijimeve, përgjigjeve me gojë) për çdo nxënës;
- listat e vlerësimit të vazhdueshëm (formativ) të përgatitura prej më parë që i plotëson mësuesi pasi bën nxënësi ndonjë aktivitet konkret që mund të jetë i veçantë (pozitiv ose negativ) ose mund të jetë studim i rastit dhe ku mësuesi shënon gjendjen faktike të nevojave individuale të nxënësit;
- instrumentet që kanë të bëjnë me secilën fushë programore. Në këto instrumente mësuesi fut të dhënat për të arriturat e nxënësit në të gjitha aspektet (kognitive-intelektuale, socio-emocionale, sociale e psikomotorike). **Listat e vlerësimit në radhë të parë duhet të përfshijnë objektivat që duhet të arrihen kur e kryen klasën e parë dhe që nuk u përkasin klasave në vijim.**

VLERËSIMI MIKROSUMATIV – Në fund të tremujorit të dytë, në bazë të të dhënave të grumbulluara, nëpërmjet vlerësimit formativ bëhet vlerësimi mikrosumativ.

VLERËSIMI SUMATIV - Duke u mbështetur në të dhënat e përgjithshme të përfutuara nga përcjellja dhe vlerësimi formativ, mësuesi e konstaton (përshkruan) shkallën e zhvillimit dhe të arriturve të çdo nxënësi veçmas në kuadër të secilës fushë programore.

FUNKSIONI I PORTFOLIOS

- ❖ Gjatë gjithë vitit shkollor prindërit duhet të kenë qasje në portfolion e fëmijës së vet që të mund të japin ndihmesën e tyre lidhur me realizimin cilësor të mësimin të gjuhës shqipe dhe për kapërcimin e vështirësive individuale të fëmijës së tij.
- ❖ Nota përfundimtare analitike me shkrim i jepet po kështu prindit dhe bëhet pjesë përbërëse e portfolios së nxënësit.
- ❖ Portfolio e nxënësit me të dhënat konkrete lidhur me arritjet dhe vështirësitë e nxënësit përcillet më tej në klasat e tjera.

MËNYRAT PËR KONTROLLIM DHE VLERËSIM - Në mbështetje të kërkesave programore të lëndës së gjuhës shqipe për klasën e parë, ku nuk mësohet lexim-shkrimi, kontrollimi dhe vlerësimi duhet të bëhen **me gojë, në mënyrë praktike, me anë të prezantimeve dhe ushtrimeve me gojë, ose nëpërmjet ushtrimeve me ilustrime ku nxënësit nënvizojnë, qarkojnë etj.**

6. KUSHTET HAPËSINORE

Mjedisi i mësimdhënies (klasa etj.) duhet t'i ketë kushtet themelore për zhvillimin normal dhe aktiv të veprimtarisë mësimore. Orenditë e klasës të mund të zhvendosen me lehtësi për t'u përshtatur me aktivitetet dhe format e punës si dhe të mundësojnë komunikim aktiv dhe pa pengesa në relacionin nxënës-nxënës, nxënës-mësimdhënës. Klasa duhet të ketë këndin e bibliotekës, këndin për lojë dhe këndin për ekspozita dhe aktivitete të tjera. Kushtet hapësinore duhet të jenë në përputhje me Normativin për kushtet hapësinore në klasën I, II, III dhe mjetet mësimore për klasën I të miratuar nga ana e ministrit të arsimit dhe shkencës me vendimin nr. 07-4061/1 të datës 31.05.2007.

7. NORMATIVI PËR KUADRIN MËSIMOR

Në bazë të Ligjit për arsimin fillor, realizimin e programit mësimor parashikohet ta bëjë mësimdhënësi që ka kryer Fakultetin Pedagogjik – profesori për mësimdhënie në klasat e ulëta përkatësisht profesori për edukimin parashkollor dhe ata që kanë kryer Fakultetin Filozofik – pedagogu i diplomuar.

8. KOMISIONI QË PËRGATITI PROGRAMIN MËSIMOR

- Doc. dr. Vehbi Kadriu, Fakulteti Pedagogjik, Shkup
- Salije Miftari, Shkolla fillore “Naim Frashëri”, Tetovë
- Ibe Mustafa, Shkolla fillore “25 Maj”, Shkup
- Kadire Hoxha, Shkolla fillore “25 Maj”, Shkup
- Fatmir Sulejmani - këshilltar pedagogjik
- Qamil Xheladini - këshilltar pedagogjik – (*koordinues*)
- Zejna Halimi - këshilltare pedagogjike

9. VENDIMI DHE DATA E MIRATIMIT TË PROGRAMIT MËSIMOR

Programin mësimor të gjuhës shqipe për klasën e parë të shkollës fillore (8-vjeçare) e miratoi ministri i Arsimit dhe Shkencës me vendimin nr. _____, të datës _____